
REFERATE E KUMTESA

LEDIA DUSHKU**LEZHA NË RRJEDHAT E LUFTËS SË PARË BALLKANIKE***

Në fund të shtatorit të vitit 1912, shtetet ballkanike filluan haptazi të demonstrojnë përgatitjet për luftë. Më 8 tetor, një ditë pasi fqinjët ballkanikë morën notën austro-ruse, që i paralajmëronte të ruanin paqen dhe të respektonin *status quo-në*, shteti më i vogël dhe më i dobët i Ballkanit, Mali i Zi i deklaroi luftë Perandorisë Osmane. Më 17 tetor edhe Serbia e Bullgaria deklaruan pjesëmarrjen e tyre në luftë. Një ditë më pas, koalicionit të shteteve ballkanike iu bashkëngjiti edhe Greqia. Filloi kështu Lufta e Parë Ballkanike.

Ecuria e Luftës në favor të shteteve ballkanike, shtroi çështjen e ndarjes së territoreve të Perandorisë Osmane, pjesë e të cilave ishin edhe viset shqiptare. Diskutimet mes Aleatëve u intensifikuan në fund të tetorit, kohë kur Fuqitë e Mëdha deklaruan prishjen e status quo-së në Ballkan.

Serbia ishte e qartë dhe e prerë në qëndrimin e saj. Rikrijimi i “Serbisë së Vjetër” përbënte qëllimin final të politikës serbe. Përfitimi i territoreve të Shqipërisë së Veriut, të cilat konsideroheshin si pjesë e qenësishme e “kombit historik serb”, përligjinin qëllimin e mësipërm. Serbia kërkonte të përfitonte territore shqiptare edhe për të dalë në bregdetin Adriatik, dalje të cilën e konsideronte jetësore për ekzistencën e saj. Kryeministri, Nikola Pašić (Nikola Pasiç), shprehej se pa këtë dalje, shteti serb nuk do të kishte frymëmarrje dhe do të ziente si kazan me kapak të mbyllur. Gjatë mesjetës, ai ishte zhvilluar, duke qenë në lidhje tregtare me shtetet evropiane, nëpërmjet porteve të Adriatikut: Durrësit dhe Lezhës. “Ta privosh atë nga kjo e drejtë me pretekstin se ajo tokë është shqiptare, do të thotë të pengosh zgjidhjen e natyrshme të çështjes ballkanike dhe të krijosh një gjendje të re që nuk mund të jetë e

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore me temë: *Kontributi i Lezhës në Lëvizjen Kombëtare dhe krijimin e shtetit modern shqiptar*, organizuar nga Bashkia Lezhë dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, më 17 janar 2013.

qëndrueshme”, përfundonte ai¹. Dalja në Adriatik i siguronte Serbisë edhe shkëputjen e shumëdëshiruar nga varësia ekonomike dhe tregtare austro-hungareze.

Qeveria serbe shprehej qartazi kundër krijimit të një minishteti shqiptar, qoftë ky edhe autonom, ndërkohë që pranonte t’u jepte shqiptarëve, që do të ishin pjesë e shtetit serb, një autonomi arsimore-kulturore. Duke dashur të shmangte një herë e përgjithmonë ndërhyrjen e Austro-Hungarisë në bregdetin Adriatik, ajo pretendonte t’i ndante territoret shqiptare me Malin e Zi dhe Greqinë, pretendim ky i sanksionuar që më 13 mars 1912, në shtojcën sekrete të Traktatit serbo-bullgar. Kufijtë e Serbisë së dëshiruar duhej të përfshinin tërë ato territore, të cilat ajo i pretendonte nën emrin “Serbi e Vjetër”, që përfshinin vilajetin e Kosovës bashkë me sanxhakun e Novi Pazarit, pjesën veriperëndimore të vilajetit të Shkodrës me bregdetin e Adriatikut dhe pjesën veriore e lindore të vilajetit të Manastirit².

Krahas Durrësit, Lezha dhe Shëngjini ishin kështu pjesë e pretendimeve territoriale serbe, pa zotërimin e të cilave Beogradi deklaronte se nuk do ta ndalte luftën. Në vitin 1912, qyteti i vogël bregdetar i Lezhës kishte një popullsi rreth 4.000 banorë dhe një jetë ekonomike të kënaqshme, me afërsisht 127 dyqane³. Për pozicionin dhe pamjen e saj madhështore, jo rastësisht Lezha ishte cilësuar si “syri i djathtë i Durrësit”⁴.

Në jetësimin e pretendimit për dalje në detin Adriatik, fillimisht Serbia siguroi mbështetjen e aleatëve ballkanikë: Bullgarisë, Malit të Zi dhe Greqisë, madje dy të fundit premtuan mbështetje jo vetëm me rrugë diplomatike, por edhe me forcë të armatosur⁵. Në përmbushje të premtimit, kryeministri dhe ministri i Jashtëm grek, zhvilluan takime me ministrin Fuqiplotë austro-hungarez në Athinë. Në to u mbështet copëtimi i territoreve shqiptare mes aleatëve ballkanikë, madje ministri i

¹ Zekeria Cana, *Politika e Serbisë kundrejt çështjes shqiptare 1903-1913*, Prishtinë: Shtypshkronja “KGT”, 2006, f. 311-312. Qarkore e Pašić-it për legatat serbe, 25 tetor 1912.

² *Po aty*, f. 233.

³ Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Tiranë: “Mihal Duri”, 1984, f. 200.

⁴ *Po aty*, f. 352.

⁵ Lefter S. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, Holt, Rinehart and Winston, 1958, f. 510.

Jashtëm guximshëm deklaroi se, një veprim i tillë ishte edhe në interes të politikës austro-hungareze. Vetëm kështu do të zhdukeshin një herë e përgjithmonë ndërlikimet në Ballkan sepse këto territore nuk do të ishin më, molla e sherrit midis dy fuqive të Adriatikut⁶. Sa për shqiptarët, ata me kohë do ta ndjenin veten të lumtur në dorën e sundimtarëve të rinj. Për kreun e diplomacisë greke, një Shqipëri e vogël dhe e cunguar ishte një foshnjë e dështuar, kurse një Shqipëri e madhe, punë që s'bëhej⁷. Njëkohësisht në takime nuk u fsheh mbështetja që qeveria greke kishte vendosur t'i jepte homologes serbe, veprim ky, që përlligjej me faktin se dalja e Serbisë në detin Adriatik dhe çështja shqiptare kishin lidhje edhe me interesat e Greqisë.

Austro-Hungaria pengesë e pakapërcyeshme për kërkesën e Serbisë për dalje në det

Situata për Serbinë paraqitej thujtë pa shpresë tek Fuqitë e Trepalëshit, ku dallohej Austro-Hungaria. Mbretëria Dualiste e konsideronte rajonin e Ballkanit si zonën e saj të influencës dhe të vetmen, ku mund të matej me Fuqitë e tjera të Mëdha. Humbja e ndikimit ndaj shteteve sllave pas vitit 1878 dhe interesi për të mos ia lënë Italisë përparësinë në rajon, kishin ndikuar në rishikimin e politikës austro-hungareze në vitet '80 të shek. XIX. Çështja shqiptare dhe Shqipëria ishin bërë kështu pjesë e rëndësishme e programit politik dhe strategjik të Ballhausplatz-it⁸ në Siujdhesën Ballkanike. Pozicioni gjeografik i territoreve shqiptare, shtrirë në bregun lindor të Adriatikut, më pak se 60 milje larg bregdetit italian, i bënte ato një zonë me interes të sigurt për Austro-Hungarinë, e cila nuk dëshironte të kishte një shtet-satelit rus, të

⁶ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.P.A.A*), në: *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 22-24-2414, Telegram i ministrit Fuqiplotë të Austro-Hungarisë në Athinë për eprorët e tij, Athinë, 14 nëntor 1912. Mbi takimin e tij me ministrin e Jashtëm grek, Koromilas; *Po aty*, Vj. 22-24-2423, Telegram i ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë për eprorët e tij, Athinë, 15 nëntor 1912. Mbi takimin e tij me Koromilas-in; *Po aty*, Vj. 22-25-2546, Telegram i ministrit Fuqiplotë të Austro-Hungarisë në Athinë për eprorët e tij në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Athinë, 28 nëntor 1912. Mbi takimin me Venizelos-in dhe Koromilas-in.

⁷ *Po aty*, Vj. 22-25-2546, Telegram i ministrit Fuqiplotë të Austro-Hungarisë në Athinë për eprorët e tij në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Athinë, 28 nëntor 1912. Mbi takimin me Venizelos-in dhe Koromilas-in.

⁸ Kështu quhej Ministria e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë.

vendosur aty. Krijimi i një shteti shqiptar pengonte zgjerimin tokësor të fqinjëve sllavë. Së bashku me Bosnje-Hercegovinën dhe Greqinë, ai krijonte kordonin antisllav në Ballkan, aq shumë i dëshiruar nga Mbretëria Dualiste. Interesi për krijimin e Shqipërisë lidhej edhe me popullsinë katolike në Veri, e cila në kuadrin e *Kultursprotektoratit* ishte marrë në mbrojtje nga Perandoria Vjenezë. Nga ana tjetër, duke mbështetur shqiptarët, Vjena jo vetëm siguronte influencën e saj në Shqipëri, por balanconte madje edhe shmangte influencën italiane aty. Sipas Memorandumit të vitit 1907, programi politik i Austro-Hungarisë për Shqipërinë dhe shqiptarët përmblidhej në togfjalëshin “Shqipëria për shqiptarët”⁹.

Shpërthimi i Luftës së Parë Ballkanike dhe ecuria e saj në favor të Aleatëve, mbarte në vetvete pasoja të rrezikshme për Mbretërinë Dualiste¹⁰. Nevojën e një ndërhyrjeje energjike, ajo e ndjeu sidomos ditët e fundit të tetorit, atëherë kur u kuptua se në Ballkan ishte e vështirë të ruhej status-quo-ja. Në këto rrethana në Ministrinë e Punëve të Jashtme u zhvilluan një sërë takimesh, për të përshtatur qëndrimin austro-hungarez. Pas diskutimesh të gjata, zyrtarët e lartë përcaktuan se një nga prioritetet e politikës vjenezë të ditës ishte krijimi i shtetit shqiptar, autonom ose të pavarur¹¹. Ai duhej krijuar për të ruajtur baraspeshën ballkanike dhe për të penguar hegjemoninë e pakufizuar të sllavëve në Ballkan. Shqipëria shihej si pengesë ndaj Serbisë, e cila kërkonte dalje në detin Adriatik, në mënyrë të pavarur nga Mali i Zi. Sipas të dërguarit austro-hungarez në Beograd, Mbretëria Habsburgase do ta kundërshtonte me vendosmëri copëtimin e Shqipërisë dhe pushtimin e Durrësit, Lezhës dhe Shëngjinit nga Serbia,

⁹ *HHSSt.A.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 17-3-373, Memorandum në lidhje me çështjen shqiptare, Szowalany, 4 tetor 1907.

¹⁰ Ndër pasojat e rrezikshme për Austro-Hungarinë mund të listojmë zgjerimin dhe forcimin e shteteve sllave në Ballkan; shtimin e influencës ruse aty; dobësimin dhe shthurjen e Perandorisë Osmane; rritjen e luftës çlirimtare të popullsisë sllave në përbërje të Austro-Hungarisë, luftë që vinte në rrezik tërësinë territoriale të shtetit habsburgas, pa lënë mënjanë edhe gjallërimin e aspiratave të Italisë në bregun lindor të Adriatikut. Për më shumë shih: Stefanaq Pollo, “Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë”, në *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare* (Përmbledhje studimesh kushtuar 50-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë), Tiranë: “Mihal Duri”, 1962.

¹¹ Karl Kaser, “The Balkan Wars, 1912-13: an Austrian perspective”, në *Crossroads of European Histories*, Council of Europe, December, 2006, f. 135.

madje në rast se kjo e fundit do të ngulte këmbë, konflikti do të ishte i pashmangshëm. Me këtë rast, Austro-Hungaria do të mbështetej nga Gjermania dhe Italia, mbase edhe nga Britania e Madhe, kurse Rusia dhe Franca nuk do të hynin në luftë kundër Aleancës Trepalëshe për shkak të Shqipërisë¹².

Në këtë situatë, që sa vinte e bëhej më e ndërlikuar e shqetësuese, ministri i Jashtëm austro-hungarez, konti Leopold von Berchtold (Leopold Berhtold), më 17 nëntor 1912, kërkoi bashkëpunimin e Italisë lidhur me rregullimin e problemit shqiptar. Në telegramin drejtuar homologut të tij italian, ai bënte me dije interesin e përbashkët që palët kishin në krijimin e një Shqipërie autonome, që duhej të përfshinte në kufijtë e saj “të gjitha territoret që banohen ekskluzivisht prej shqiptarëve, ose të paktën, krahina të banuara në shumicë prej tyre”¹³. Austro-Hungaria nuk e mbështeste daljen e Serbisë në Adriatik, ndërsa në lidhje me kufijtë e Jugut, pranonte t’i jepte Greqisë territorin në jug të lumit Kalamas¹⁴.

Në dallim nga Vjena, Roma ishte skeptike, veçanërisht sa i përket pjekurisë së shqiptarëve, për të siguruar dhe mbrojtur autonominë. Ministri i Jashtëm italian, markezi San Guiliano (San Xhuliano) nuk ngurronte ta përcaktonte Shqipërinë si vend të vobektë e primitiv, që çdo shtet fqinj “donte ta priste nga të katër anët”¹⁵. Ndonëse qeveria italiane shprehej se “kurrësi nuk do ta japim votën tonë që Serbia të marrë Shëngjinit dhe as që na shkon ndërmend për ta shkëputur këtë liman prej Shqipërisë”¹⁶, ajo besonte se ishte e vështirë të ndahej, fati i Shëngjinit nga ai i Shkodrës. Në këtë situatë, Roma mendonte se për shkak të rrethanave gjeografike dhe ekonomike, qeveria Perandorake dhe

¹² Z. Cana, *Politika e Serbisë kundrejt...*, f. 313.

¹³ *HHSSt.A.P.A.A* në *AIH*, Vj. 22-7-709, Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për homologun e tij italian (nëpërmjet ambasadorit austro-hungarez në Romë), Budapest, 17 nëntor 1912.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*, Vj. 22-11-1163, Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Romë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Romë, 19 nëntor 1912. Mbi takimin me ministrin italian të Punëve të Jashtme.

¹⁶ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI (nëntor-dhjetor 1912), përgatitja dhe redaktimi shkencor Marenglen Verli, Ledia Dushku, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012, f. 310-311, Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Romë dërguar ministrit të Punëve të Jashtme, Romë, 25 nëntor 1912.

Mbretërore Austro-Hungareze duhej ta shihte të udhës që Shëngjini, ndoshta edhe Lezha t'i lireshin Malit të Zi, me disa kushte. Kjo gjë do të lehtësonte zgjidhjen e vështirësive me Serbinë, sa i përket lirisë së komunikimeve me Adriatikun, kur dihej se ishte tej mundësive të Malit të Zi, bërja e Shëngjinit një port të përdorshëm tregtar, për shkak të shpenzimeve të shumta që kërkonte.

Pavarësisht sa më sipër, Italia e kishte kuptuar se fati i mëtejshëm i territoreve shqiptare kishte rëndësi të veçantë për të. Me to lidhej jo vetëm rivaliteti me Austro-Hungarinë për supremacinë në Adriatik, por edhe gjithë politika e saj ekspansioniste në drejtim të Gadishullit të Ballkanit¹⁷. Qarqet italiane nuk mund të ishin të shkujdesura përballë forcimit të Serbisë e të Greqisë në Adriatik e Jon. Për të evituar çdo surprizë, Roma mbështeti qëndrimin e Vjenës për çështjen shqiptare, kundër pretendimeve serbe e greke dhe ndërhyrjes së Fuqive të Antantës. Më 26 nëntor 1912, San Guiliano njoftoi mbështetjen italiane për propozimin e Berchtold-it¹⁸. Nisën kështu diskutimet për ripërtëritjen e Paktit Trepalësh, ripërtëritja e të cilit u deklarua në fillim të dhjetorit. Pakti i siguronte Italisë përkrahjen e Austro-Hungarisë për të bllokuar depërtimin e ndikimeve të tjera në Adriatik dhe e detyronte këtë të fundit të mos ndërmerre asnjë veprim në Ballkan, pa u marrë vesh me Italinë¹⁹. Në këtë mënyrë, të dyja fuqitë ndanin ndikimin e tyre edhe në Shqipëri.

Qëndrimi i dy Fuqive të Trepalëshit dhe mbështetja që ato kishin vendosur t'i jepnin çështjes shqiptare nxiti shtetet ballkanike të përshpejtonin veprimet ushtarake. Ato pretendonin t'i pushtonin territoret shqiptare sa më shpejt të ishte e mundur, pa u arritur marrëveshja e armëpushimit me Perandorinë Osmane dhe pa u mbledhur Konferenca e Ambasadorëve në Londër.

Pushtimi i Lezhës

Në dokumentacionin arkivor, ku spikat ai austro-hungarez, bëhet me dije se Serbia, në përpjekje për të pushtuar Lezhën dhe Shëngjinin, fillimisht përdori si karrem Malin e Zi. Kjo, si një orvatje për të matur

¹⁷ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare, 1878-1926*, Tiranë: "Albin", 2003, f. 85.

¹⁸ *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 22-14-1424, Përgjigja që Italia i jep propozimeve të Austro-Hungarisë, në lidhje me çështjen e autonomisë së Shqipërisë, Romë, 26 nëntor 1912.

¹⁹ A. Puto, *Historia diplomatike e çështjes...*, f. 85-86.

pulsin e Fuqive të Mëdha, veçanërisht të “armikes” së saj kryesore, Austro-Hungarisë. Nën pretekstin se Shëngjini ishte mushkëria e Shkodrës, çka i bënte këto dy zona të pandashme me njëra-tjetrën, më 5 nëntor 1912 ushtritë malazeze pushtuan Lezhën dhe Shëngjinin²⁰. Ashtu siç edhe pritej, reagimi i Austro-Hungarisë qe i menjëhershëm. Pushtimi i dy porteve, qoftë edhe nga Mali i Zi, nuk do të tolerohej prej saj. I dërguari austro-hungarez në Cetinë, në emër të ministrit të Punëve të Jashtme, kontit Berchtold i bëri me dijë krajl Nikollës se, Lezha dhe Shëngjini nuk do t’i takonin as Malit të Zi, as Serbisë, por Shqipërisë autonome. Në përgjigjen e tij aspak diplomatike, Mbreti malazez me shprehje luftënxitëse u shpreh: “Më parë Buna do të rrjedhë gjak, se të bëhet një gjë e tillë”²¹.

Qëllimi e serbëve dhe malazezëve ishte i qartë, të pushtoheshin sa më shumë territore të ishte e mundur, në mënyrë që në Konferencën e Ambasadorëve që pritej të mbledhej, të shpëtohej pjesa më e madhe dhe e fortdëshiruar e tyre. Në kuadrin e bashkëpunimit mes tyre, Mali i Zi linte të kuptohej se do të tërhiqej nga Lezha dhe Shëngjini, ndërkohë që Serbia përgatitej të vepronte në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke i pushtuar këto territore. Pa filluar ende negociatat e armëpushimit me Perandorinë Osmane, armata e tretë serbe mori urdhër të bënte të gjitha përpjekjet që brenda 2-3 ditëve të dilte në bregdetin shqiptar, sepse nëse bisedimet e paqes do të fillonin përpara pushtimit të Lezhës dhe Durrësit, dalja e Serbisë në det do të dështonte plotësisht. Qeveria serbe e gjykonte situatën politike ndërkombëtare të favorshme për planet e saj. Në telegramin që Pašić i dërgoi Komandës së Lartë në Shkup theksonte: “..Diplomacia është e disponuar, veçse na jep këshilla të depërtojmë në detin Adriatik sa më parë, sepse së shpejti do të fillojë aksioni i përbashkët i fuqive evropiane për ndërprerjen e luftës dhe fillimin e negociatave të paqes”²². Nga Shën Petersburg-u mesazhi që vinte ishte i qartë: depërtim pa zhurmë e bujë deri në bregdetin Adriatik për ta vënë kështu Europën para faktit të kryer. Por, ndërsa kreu i diplomacisë ruse ritheksonte qëndrimin e palëkundur të qeverisë së tij për të rrudhur territorin e shtetit shqiptar deri në minimum, vinte në dukje se Shëngjini

²⁰ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, f. 128, Telegram i kontit Berchtold për ministrin Fuqiplotë të Austro-Hungarisë në Cetinë, Vjenë, 10 nëntor 1912.

²¹ Z. Cana, *Politika e Serbisë kundrejt....*, f. 314.

²² *Po aty*, f. 292.

dhe Lezha nuk ishin të përshtatshëm për porte²³. Ndërkohë, inkurajimi në heshtje i diplomacisë franceze dhe gjakftohtësia e asaj britanike, perceptoheshin prej Beogradit zyrtar si avantazhe kundrejt sulmit në bregdetin shqiptar. Por jo gjithmonë, perceptimi shprehte realitetin. Në rastin e qëndrimit britanik, nuk mungonin deklaratat që vinin në pikëpyetje mbështetjen ndaj planeve serbe. Një e tillë ishte ajo e ministri Fuqiplotë britanik në Beograd se vendi i tij nuk do të hynte në luftë për shkak të Shëngjinit e Lezhës²⁴.

Javën e parë të nëntorit 1912, Komanda e Lartë në Shkup urdhëroi prerazi komandantin e Armatës së Tretë që të formonte dy reparte të posaçme ushtarake, të cilat do të operonin nga Prizreni dhe Gjakova për të depërtuar drejt Lezhës, Shëngjinit e Durrësit²⁵. Operacionet duhej të përfundonin për dy ditë, pa marrë parasysh faktin se ushtria ishte e rraskapitur nga marshimet e gjata e të vështira, moti i keq dhe ushqimi i pamjaftueshëm. Kolonat u nisën më 9 nëntor. Për të dobësuar reagimin e shqiptarëve, serbët përdorën mollën e sherrit. U përpoqën të ndezin përçarjen ndërmjet fshatarëve myslimanë e katolikë, duke e shpallur veten mbrojtës të palës së dytë. Pavarësisht kësaj politike, gjatë rrugës Prizren–Lezhë, ushtria serbe u sulmua në mënyrë të pandërprerë nga malësorët, çka e detyroi komandën të dërgonte forca të reja nga Prizreni e Gjakova. Kolona kryesore serbe vazhdoi marshimin për të dalë sa më parë në Lezhë. Tërheqja e batalionit osman në Shkodër e dobësoi mbrojtjen dhe krijoi kushte lehtësuese për zbritjen e korpusit të Drinit në rrafshin e Drinit të Poshtëm.

Pasi shkelën Mjedën, serbët hynë në Kallmet dhe në Troshan dhe, më 18 nëntor 1912 në bashkëveprim me malazezët që vinin nga Shëngjini, iu afruan Lezhës. Pas luftimesh të ashpra, ushtritë serbo-malazeze e morën qytetin, më 22 nëntor.

Pasi u pushtua edhe Durrësi, Armata e Tretë serbe shpalli menjëherë krijimin e Krahinës Bregdetare Ushtarake me kufij: gjiri i Shëngjinit-Durrës-gryka e Shkumbinit-Elbasan.

²³ *Po aty*, f. 302.

²⁴ *Po aty*, f. 294.

²⁵ *Po aty*.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër:**Lezha pjesë e shtetit shqiptar**

Pavarësisht se Fuqitë e Mëdha përgjithësisht nuk i mbështetën pretendimet serbe për daljen në Adriatik, qeveria serbe qëndroi kryeneçe. Më 7 dhjetor 1912, Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë i transmetoi qeverisë greke një notë, me anën e së cilës i bënte me dije: “Meqenëse të gjithë Fuqitë kanë rënë dakord për autonominë e Shqipërisë, Serbia heq dorë nga kërkesa për ndarjen e Shqipërisë dhe pajtohet me autonominë në kufijtë e ngushtë, që fillojnë menjëherë nën Durrës dhe shkojnë bregdetit në Jug, deri në vijën e pretendimeve greke. Serbia kërkon medoemos Durrësin me hinterlandin në lindje dhe bregdetin nga Durrësi deri në Lezhë...”²⁶.

Fillimi i punimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe ecuria e tyre nuk qenë ogur i mirë për pretendimet serbe në Adriatik. Që në seancën e parë të datës 17 dhjetor 1912, u ra dakord që Serbisë t’i mohohet dalja në Adriatik nëpërmjet territorit të Shqipërisë së Veriut, pavarësisht se ajo ishte një nga kërkesat kryesore të Beogradit. Në këmbim, Serbia do të kishte mundësi hyrjeje, përmes lidhjeve hekurudhore, me port neutral. Por, porti nuk u specifikua, sepse austriakët kishin rrëzuar sugjerimin për Shëngjnin të kryediplomatit britanik, Edward Grey (Eduart Grei). Ambasadorët miratuan këtë formulë: “Një dalje tregtare do t’i lihet Serbisë nëpërmjet një porti shqiptar të lirë dhe neutral, i shërbyer nga një hekurudhë ndërkombëtare nën kontrollin evropian dhe nën kujdesin e një force të posaçme ndërkombëtare me liri transiti për të gjitha mallrat, duke përfshirë edhe municionet e posaçme”²⁷. Tre muaj më vonë, në vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të datës 10 mars 1912 bëhej me dije se, “Fuqitë e Mëdha konsiderojnë që Serbia është e detyruar të tërhiqet nga bregdeti dhe territori shqiptar, sapo fuqitë të marrin vendim për kufijtë e Shqipërisë”²⁸. Vendimi përfundimtar i Konferencës për kufijtë veriorë

²⁶ *Po aty*, f. 318.

²⁷ A. Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik)*, Vëllimi II (1812-1918), Tiranë: “8 Nëntori”, 1987, f. 189, Përmbledhje mbi seancën e 17 dhjetorit 1912, që përmban vendimet paraprake mbi organizimin e Shqipërisë dhe caktimin e kufijve të saj.

²⁸ Z. Cana, *Politika e Serbisë.....*, f. 382.

dhe verilindorë të Shqipërisë u mor më 22 mars 1913. Nisur që nga kjo datë trupat serbe duhej të tërhiqeshin.

Në zbatim të këtij vendimi, më 13 prill 1913, Komanda e Lartë në Shkup mori urdhrin për tërheqjen e të gjitha trupave nga bregdeti²⁹. Në zbatim të urdhrit serbët u larguan nga Lezha dhe gjithë zona bregdetare shqiptare. Me një urdher të posaçëm të Pašić-it, vetëm në Durrës mbeti një regjiment i këmbësorisë së bashku me një skuadër kavalerie dhe bateri artilerie.

²⁹ *Po aty*, f. 427.